



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____._____2026

PROCES VERBAL

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – E Hapur, Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: F.V. Lodra/Materiale per ambjente rekreative per femije ne Bashkine Vlore dhe Njesite Administrative.

REF-98293-08-31-2026

FONDI LIMIT:12,313,333 (dymbedhete milion e treqind e trembedhete mije e treqind e tridhete e tre) leke PA TVSH.

Kodi CPV: 37520000-9 – Lodra

Tipi i Proçedurës: E hapur, Mallra

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vlore** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për te Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të lotit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se:

Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale parashikuar të kontratës; ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b)vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomik dhe financiar per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi bazuar ne vleren e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që*

mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe
nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku
përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

- 2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësie. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Njësia e Prokurimit gjykon të nevojshme vendosjen e kriterit që operatorët ekonomikë të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve **2023, 2024 dhe 2025**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, me qëllim verifikimin e gjendjes dhe qëndrueshmërisë së tyre financiare. Paraqitja e pasqyrave financiare për tre vitet e fundit ushtrimore shërben për të vlerësuar vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik dhe aftësinë e operatorit për të përballuar angazhimet financiare që lidhen me realizimin e kontratës. Ndërkohë, kërkesa që, në rastet kur operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 41 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, bilancet të shoqërohen me raportet e auditimit ligjor, synon garantimin e besueshmërisë dhe korrektësisë së informacionit financiar të paraqitur. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse, në **dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara**, nuk rezultojnë një raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Ky përcaktim synon të sigurojë që operatori ekonomik të mos paraqesë një gjendje të paqëndrueshme financiare për një periudhë të vazhdueshme, e cila mund të ndikojë në aftësinë e tij për të realizuar detyrimet kontraktore. Për rrjedhojë, kriteri është vendosur në funksion të verifikimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar të operatorëve pjesëmarrës, duke garantuar që operatori fitues të disponojë një gjendje financiare të përshtatshme për realizimin e kontratës, pa krijuar kufizime të panevojshme ose diskriminuese ndaj pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Kërkesa që, në rastet kur operatori ekonomik është subjekt i auditimit ligjor sipas legjislacionit në fuqi, bilancet të shoqërohen me **raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore**, synon garantimin e besueshmërisë dhe korrektësisë së informacionit financiar të paraqitur.

Gjithashtu, përcaktimi që kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në **dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk rezultojnë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit**, ka për qëllim të verifikojë që operatori ekonomik disponon një **pozicion financiar të qëndrueshëm**, ku aktivitetet janë në gjendje të mbulojnë detyrimet e tij. Ky tregues shërben si një element objektiv për të vlerësuar aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik për përmbushjen e kontratës.

Në këtë mënyrë, kriteri është vendosur në funksion të garantimit të një procesi prokurimi të sigurt dhe të besueshëm, duke mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që paraqesin **kapacitet financiar të**

mjaftueshëm dhe qëndrueshmëri ekonomike, pa krijuar kufizime të panevojshme ose joproportionale ndaj konkurrencës.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për kestet e maturuara të vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore është përcaktuar me qëllim **verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe fiskale** nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e operatorëve ekonomikë për të përmbushur detyrimet e tyre ndaj njësitë të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore, dhe shërben si element verifikues i gjendjes së tyre administrative dhe fiskale. Përcaktimi i detyrimeve për **këstet e maturuara të vitit 2026**, sipas të dhënave të QKB-së, synon që verifikimi të lidhet me detyrimet aktuale të operatorit ekonomik dhe me njësitë të vetëqeverisjes vendore në të cilat ai ushtron aktivitet. Përfshirja e këtij kriteri është në përputhje me kërkesat ligjore dhe synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të jenë në përmbushje të detyrimeve të tyre vendore. Për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa ndaj çdo anëtarit është e nevojshme për të verifikuar përmbushjen individuale të detyrimeve ligjore nga secili anëtar i grupit.

2.3. Për kapacitetin teknik: Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme të realizuar me një ent publik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku te shenohen, vlera, afati i perfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shenohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shenohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin parashikohet se:

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se:

*4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kërkesa për paraqitjen e dëshmive për furnizime të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë **3 (tre) viteve të fundit**, në një vlerë jo më të vogël se **40% e fondit limit**, është përcaktuar me qëllim verifikimin e **kapacitetit teknik dhe profesional** të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të furnizimeve objekt të kësaj procedure.Përvoja në realizimin e furnizimeve të ngjashme dëshmon se operatori ekonomik ka eksperiencën, organizimin dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur kërkesat që lidhen me furnizimin, transportin dhe, sipas rastit, montimin dhe vendosjen e pajisjeve objekt të prokurimit.Përcaktimi i vlerës së furnizimeve të ngjashme në masën **40% të fondit limit** synon të sigurojë një nivel të arsyeshëm përvoje të mëparshme, në raport me madhësinë dhe natyrën e kontratës, pa kërkuar që operatori ekonomik të ketë realizuar kontrata me vlerë të barabartë me të gjithë fondin limit.Kufizimi i periudhës së referencës në **3***

vitet e fundit siguron që përvoja e paraqitur të jetë relevante dhe relativisht e fundit, duke dhënë një tregues më të përshtatshëm mbi aftësinë aktuale të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën. Dokumentacioni i kërkuar për provimin e furnizimeve të mëparshme, përfshirë vërtetimet e enteve publike dhe/ose faturat tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, synon të sigurojë **verifikueshmërinë dhe autenticitetin e përvojës së deklaruar** nga operatorët ekonomikë. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe vlerësohet **e nevojshme dhe proporcionale**, pasi synon të garantojë që operatori ekonomik i përzgjedhur disponon përvojën e mjaftueshme për realizimin e furnizimit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) automjet transporti në pronësi ose me qira, me qëllim transportin e mallrave. Për automjetin duhet të paraqitet dokumentacioni që provon disponimin e tij, sipas rastit.

sasitë Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër

Argumentimi: Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mësipërme i shërben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve. Kërkesa për disponimin e të paktën **1 (një) automjeti transporti**, në pronësi ose me qira, është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, përmasat dhe karakteristikat e pajisjeve objekt të prokurimit, të cilat përfshijnë pajisje rekreative dhe sportive për fëmijë, si lisharëse, pelikundëse, pajisje rrotulluese, komplekse lojërash, pajisje fitnesi, pajisje ngjitjeje, tabela basketbolli dhe materiale për shtrime gome. Disponimi i një automjeti të përshtatshëm është i nevojshëm për të garantuar **transportin e sigurt dhe në kohë të mallrave** deri në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, si dhe për përmbushjen e detyrimit për furnizim, transport, montim dhe vendosje të pajisjeve. Kërkesa për disponimin e automjetit **në pronësi ose me qira** krijon mundësi alternative për përmbushjen e kriterit dhe nuk kushtëzon operatorët ekonomikë që automjeti të jetë në pronësi të tyre, duke kontribuar në ruajtjen e konkurrencës. Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe vlerësohet **i nevojshëm dhe proporcional**, pasi siguron kapacitetin

minimal logjistik të nevojshëm për realizimin e furnizimit dhe nuk kërkon një numër apo kapacitet automjetesh përtej nevojave të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nëpërmjet së cilës garanton një periudhë garancie prej 1 (një) viti për mallrat objekt të prokurimit, e cila fillon nga data e dorëzimit dhe vendosjes/montimit të tyre. Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik merr përsipër të kryejë, pa pagesë shtesë për Autoritetin Kontraktor, riparimin, mirëmbajtjen dhe/ose zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara, për defekte që vijnë si rezultat i cilësisë së materialeve, prodhimit dhe/ose montimit

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për një periudhë garancie prej **1 (një) viti** për mallrat objekt të prokurimit është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e pajisjeve rekreative dhe sportive që do të furnizohen, si dhe faktin që ato do të përdoren në mënyrë të vazhdueshme nga fëmijët dhe përdoruesit e tjerë. Periudha e garancisë synon të sigurojë cilësinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e pajisjeve pas furnizimit dhe montimit të tyre, si dhe të garantojë ndërhyrjen e operatorit ekonomik në rast të shfaqjes së defekteve që lidhen me cilësinë e materialeve, procesin e prodhimit ose montimin. Përcaktimi i fillimit të periudhës së garancisë nga data e dorëzimit dhe vendosjes/montimit është i nevojshëm, pasi pajisjet nuk konsiderohen të gatshme për përdorim vetëm me dorëzimin e tyre, por pas montimit dhe vendosjes në pozicionin përfundimtar. Detyrimi i operatorit ekonomik për të kryer riparimin, mirëmbajtjen dhe/ose zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara pa pagesë shtesë synon të sigurojë që defektet e shkaktuara nga cilësia e materialeve, prodhimi ose montimi të korrigjohen brenda periudhës së garancisë, pa krijuar kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor. Kërkesa për garanci është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe vlerësohet e nevojshme dhe proporcionale, pasi pajisjet do të jenë në përdorim të vazhdueshëm dhe siguria dhe funksionaliteti i tyre janë elementë të rëndësishëm për realizimin e qëllimit të furnizimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë transportin, montimin dhe vendosjen e të gjithë artikujve objekt të prokurimit, sipas specifikimeve teknike dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor, në vendet e përcaktuara prej tij, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kërkesa për paraqitjen e deklaratës është e nevojshme për të garantuar se operatori ekonomik merr përsipër realizimin e plotë të detyrimeve që lidhen me **transportin, montimin dhe vendosjen e artikujve objekt të prokurimit**, në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e

Autoritetit Kontraktor. Pajisjet objekt të prokurimit, për shkak të natyrës, përmasave dhe karakteristikave të tyre, kërkojnë transport dhe, për një pjesë të tyre, montim dhe vendosje në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Realizimi i saktë i këtyre shërbimeve është i domosdoshëm për sigurimin e **funksionalitetit, qëndrueshmërisë dhe përdorimit të sigurt të pajisjeve**. Përcaktimi që këto shërbime të kryhen **pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor** synon të sigurojë që të gjitha kostot që lidhen me realizimin e plotë të furnizimit të jenë të përfshira në ofertën e operatorit ekonomik dhe të mos krijohen detyrime financiare shtesë gjatë zbatimit të kontratës. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe konsiderohet **e nevojshme dhe proporcionale** me natyrën e furnizimit.

2.3.5 Operatori ekonomik, për produktet e ofertuara, duhet të paraqesë dokumentacion teknik që vërteton përputhshmërinë e produkteve me standardet teknike të përcaktuara në specifikimet teknike, konkretisht:

Pajisjet/lodrat e këndeve të lojërave për fëmijë: sipas artikullit përkatës, të paraqitet certifikatë konformiteti, raport vlerësimi të konformitetit, raport testimi ose dokumentacion teknik ekuivalent, që dëshmon përputhshmërinë me SSH EN 1176-1 dhe, kur është e aplikueshme sipas tipologjisë së pajisjes, me pjesën specifike përkatëse të serisë SSH EN 1176, ose standard ekuivalent.

2. Pajisjet e fitnesit të jashtëm: të paraqitet certifikatë konformiteti, raport vlerësimi të konformitetit, raport testimi ose dokumentacion teknik ekuivalent që dëshmon përputhshmërinë me SSH EN 16630:2015, ose standard ekuivalent.

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë lëshuar nga organisma të akredituara të vlerësimit të konformitetit/laboratorë të akredituar për fushën përkatëse, sipas rastit.

Argumentimi: Kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.5 është vendosur për të garantuar që pajisjet e lojërave për fëmijë, pajisjet e fitnesit në ambiente të jashtme, strukturat e basketbollit dhe sipërfaqet amortizuese që do të furnizohen dhe instalohen në kuadër të këtij prokurimi të përmbushin kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara për përdorimin e tyre.

Duke qenë se objekt i kontratës janë pajisje të destinuara për përdorim nga fëmijë dhe qytetarë në ambiente publike, mosverifikimi paraprak i kërkesave të sigurisë dhe i karakteristikave teknike të produkteve mund të krijojë rrezik për përdoruesit dhe për qëndrueshmërinë e investimit publik. Për këtë arsye, kërkohet paraqitja e dokumentacionit teknik të përshtatshëm që mundëson verifikimin objektiv të përputhshmërisë së produkteve të ofertuar me standardet teknike të përcaktuara në specifikimet teknike.

Për pajisjet dhe lodrat e këndeve të lojërave për fëmijë, referimi te **SSH EN 1176-1** dhe, sipas tipologjisë së pajisjes, te pjesët specifike të serisë **SSH EN 1176**, synon të sigurojë që pajisjet plotësojnë kërkesat teknike dhe të sigurisë lidhur me projektimin, materialet, ndërtimin, qëndrueshmërinë, montimin dhe përdorimin e tyre, duke minimizuar rrezikun e dëmtimeve gjatë përdorimit nga fëmijët.

Kërkesa për përputhshmërinë e sipërfaqeve amortizuese të impaktit me standardin **SSH EN 1177**, ose standard ekuivalent, është përcaktuar me qëllim garantimin e **sigurisë së fëmijëve gjatë përdorimit të këndeve të lojërave**.

Sipërfaqet amortizuese kanë funksion të reduktojnë pasojat e mundshme të rënieve nga pajisjet e lojërave dhe përbëjnë një element të rëndësishëm të sigurisë së këndeve të lojërave. Për këtë arsye, verifikimi i karakteristikave të tyre teknike dhe i aftësisë për të amortizuar goditjen është i domosdoshëm për të siguruar që produktet e ofertuara janë të përshtatshme për përdorimin e synuar.

Kërkesa për paraqitjen e **certifikatës së konformitetit, raportit të testimit ose dokumentacionit teknik ekuivalent**, të lëshuar nga organizma ose laboratorë të akredituar për fushën përkatëse, synon të sigurojë **verifikim objektiv dhe të besueshëm të performancës së produktit**.

Pranimi i standardeve ekuivalente garanton që kërkesa të mos kufizojë konkurrencën dhe lejon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që ofrojnë produkte me **nivel të njëjtë ose të barasvlershëm sigurie dhe performance teknike**

Për pajisjet e fitnesit të jashtëm, kërkesa për përputhshmëri me **SSH EN 16630:2015** synon të garantojë që pajisjet janë të projektuara dhe të prodhuara në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë dhe përdorimit të pajisjeve të fitnesit të instaluar në ambiente të jashtme.

Kërkesa që përputhshmëria të dëshmohet nëpërmjet **certifikatës së konformitetit, raportit të vlerësimit të konformitetit, raportit të testimit ose dokumentacionit teknik ekuivalent**, lejon verifikimin objektiv të karakteristikave dhe performancës së produkteve të ofertuara dhe shmang vlerësimin vetëm mbi bazën e deklarimeve të operatorit ekonomik.

Përcaktimi që dokumentacioni të jetë lëshuar nga **organizma të akredituara të vlerësimit të konformitetit ose laboratorë të akredituar për fushën përkatëse**, sipas rastit, synon të sigurojë **besueshmërinë dhe vlefshmërinë teknike të dokumenteve të paraqitura**.

Kërkesa për pranimin e **standardit ekuivalent** siguron që kriteri të mos kufizojë konkurrencën vetëm te një standard i caktuar, për sa kohë operatori ekonomik provon se produkti i ofruar përmbush kërkesa teknike dhe të sigurisë të njëjta ose të barasvlershme me ato të kërkuara.

Në përfundim, ky kriter është i nevojshëm dhe proporcional me objektin e prokurimit, pasi pajisjet do të përdoren në **hapësira publike dhe, në rastin e këndeve të lojërave, drejtpërdrejt nga fëmijët**, ndaj verifikimi paraprak i kërkesave të sigurisë dhe konformitetit teknik është i domosdoshëm për garantimin e përdorimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të pajisjeve.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog dhe/ose fletë teknike të prodhuesit për pajisjet dhe artikujt e ofertuar, në të cilat të identifikohen qartë emërtimi i produktit, prodhuesi, modeli (kur aplikohet) dhe karakteristikat teknike përkatëse, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofertuar me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Në katalog/fletën teknike duhet të evidentohen qartë artikujt e ofertuar dhe karakteristikat teknike që lidhen me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike

Argumentimi ligjor dhe teknik: Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar

Kërkesa për paraqitjen e katalogut dhe/ose fletës teknike të prodhuesit është përcaktuar me qëllim **identifikimin**

dhe verifikimin objektiv të produkteve të ofertuar, si dhe të karakteristikave të tyre teknike. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin pajisje të ndryshme rekreative, sportive dhe materiale për përdorim nga fëmijët, si lisharëse, pelikundëse, pajisje rrotulluese, komplekse lojërash, pajisje ngjitjeje, pajisje fitnesi, tabela basketbolli dhe pllaka gome, është e nevojshme që karakteristikat e produkteve të ofertuar të mund të krahasohen dhe verifikohen me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike. Evidentimi i qartë në katalog ose fletën teknike i **emërtimit të produktit, prodhuesit, modelit, kur aplikohet, dhe karakteristikave teknike përkatëse** mundëson identifikimin e saktë të produktit të ofertuar dhe shmang paqartësitë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Kërkesa që artikujt e ofertuar dhe karakteristikat teknike që lidhen me kërkesat e Autoritetit Kontraktor të jenë **qartësisht të evidentuara**, synon të lehtësojë procesin e verifikimit të përputhshmërisë teknike dhe të sigurojë një vlerësim sa më objektiv dhe transparent të ofertave. Kërkesa është **e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, e nevojshme dhe proporcionale**, pasi nuk përcakton një markë apo prodhues të caktuar, por kërkon vetëm dokumentacion teknik të mjaftueshëm për të provuar karakteristikat e produktit të ofertuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i pune i krijuar për hartimin e e projektit „preventivit, afatit të punimeve dhe relacionin teknik”, në përputhje me nenin 4, pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur D.S.T-ve në S.P.E

- a) Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat funksionale të Autoritetit Kontraktor, destinacionin e produkteve dhe kushtet e përdorimit të tyre, me qëllim sigurimin e pajisjeve rekreative dhe sportive të përshtatshme për fëmijët dhe përdoruesit e hapësirave përkatëse. Për përcaktimin e specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë karakteristikat kryesore të pajisjeve, përfshirë përmasat, materialet e konstruksionit, kapacitetin, qëndrueshmërinë, funksionalitetin dhe elementet e sigurisë, në përputhje me llojin dhe mënyrën e përdorimit të secilit artikull. Për pajisjet e lojërave, si lisharëset, pelikundëset, pajisjet rrotulluese, komplekset e lojërave dhe pajisjet e ngjitjes, specifikimet synojnë të garantojnë qëndrueshmëri, siguri dhe përdorim të përshtatshëm nga fëmijët, duke marrë në konsideratë ngarkesat dhe mënyrën e funksionimit të tyre. Për pajisjet sportive dhe të fitnesit janë përcaktuar karakteristika që synojnë të garantojnë funksionalitetin, rezistencën dhe përshtatshmërinë për përdorim të rregullt, ndërsa për tabelat e basketbollit dhe strukturat përkatëse kërkesat teknike synojnë sigurimin e

qëndrueshmërisë dhe përdorimit të sigurt. Për materialet e shtrimit prej gome janë përcaktuar karakteristika si përmasat dhe trashësia, me qëllim sigurimin e një sipërfaqeje të përshtatshme për përdorimin e parashikuar dhe rritjen e sigurisë në hapësirat ku vendosen pajisjet rekreative. Specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë që të lejojnë pjesëmarrjen e produkteve ekuivalente, pa iu referuar një marke, prodhuesi ose burimi të veçantë, përveç rasteve kur një referim i tillë justifikohet objektivisht nga nevoja teknike dhe lejohet nga legjislacioni në fuqi. Në hartimin e specifikimeve është synuar ruajtja e një raporti të drejtë ndërmjet kërkesave teknike, cilësisë, sigurisë, funksionalitetit dhe kostos, duke shmangur kërkesat që nuk janë të domosdoshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në përfundim, specifikimet teknike janë përcaktuar në funksion të sigurimit të pajisjeve cilësore, të qëndrueshme, funksionale dhe të sigurta, të përshtatshme për përdorimin e tyre të parashikuar, duke garantuar njëkohësisht konkurrencë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

